



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-055

Prishtinë, më 24 dhjetor 2018, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**P R O C E S V E R B A L**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 24 DHJETOR 2018**

**Në mbledhje morën pjesë:** Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Kujtim Shala dhe Aida Dërguti, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare:** Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Albulena Haxhiu, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit:** Gazmend Krasniqi dhe Avni Bytyqi.

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

**Nga NDI-ja:** Shefki Kastrati.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, i zhvilloi punimet me këtë:

#### **Rend dite**

**1. Kërkesa e 40 deputetëve për seancë të jashtëzakonshme për të diskutuar mbi dokumentin e përgatitur nga Qeveria e Republikës së Kosovës, si: “Draft-marrëveshja gjithëpërfshirëse ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë”**

Kryetari i njoftoi të pranishmit se kërkesa e 40 deputetëve për mbajtje të seancës së jashtëzakonshme i plotëson të gjitha kushtet e parapara me Kushtetutë dhe me Rregulloren e Kuvendit.

Kryesia vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet të mërkurën, më 26 dhjetor 2018, në orën 10:00, me këtë:

#### **Rend dite**

*1. Diskutim mbi dokumentin e përgatitur nga Qeveria e Republikës së Kosovës, si: “Draft-marrëveshja gjithëpërfshirëse ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë”.*

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 14:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*